

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.251/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi -Kryetar, znj. Kimete Gashi - Referuese, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Haxha Kom”SH.P.K.-Vushtrri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial-Marrëveshje Mirëkuptimi: Komuna MZHR-MAPL dhe DEMOS”, me nr. të prokurimit: 642-22-5761-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK- “Mitrovicë”, më datën: 25.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Haxha Kom”SH.P.K.-Vushtrri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial- Marrëveshje Mirëkuptimi: Komuna MZHR-MAPL dhe DEMOS”, me nr. të prokurimit: 642-22-5761-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK- “Mitrovicë”,

II.OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial- Marrëveshje Mirëkuptimi: Komuna MZHR-MAPL dhe DEMOS”, me nr. të prokurimit: 642-22-5761-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK- “Mitrovicë”, të bëj ndryshimet e nevojshme për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Haxha Kom”SH.P.K.-Vushtrri, aprovet si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Haxha Kom”SH.P.K.-Vushtrri, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.07.2022 me nr. 251/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial- Marrëveshje Mirëkuptimi: Komuna MZHR-MAPL dhe DEMOS”, me nr. të prokurimit: 642-22-5761-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK- “Mitrovicë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 7 , 27 si dhe nenin 69 të LPP-së, si dhe nenin 18.9, dhe 26.4 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nënit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 02.08.2022, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : “Haxha Kom”SH.P.K.-
Vushtri,

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE “HAXHA KOM” SH.P.K. Gojbulë –Vushtri se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – ka përcaktuar kushte dhe kritere për pjesëmarrje në kundërshtim me LPP-në Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi pika 1 dhe 2 Tek kërkesa e nenit 9.1&9.2 FDT-s pika c) AK-ja ka kërkuar "Minimum një Punëtorë për saldime nën ujë", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Kontrata e punës me ofertuesin, referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit, nëse nuk gjendet në marrëdhënie punë të ofrohet kontratë për angazhim në emër të projektit Për këtë pikë punëtori duhet të jetë i certifikuar me certifikatë EN 13067 2013. Për saldime nënë ujë."

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga OE “HAXHA KOM” SH.P.K. Gojbulë –Vushtri Pas shqyrtimit të dosjes se tenderit, Njoftimin për Kontratë – pika III.2) kushtet për pjesëmarrje, paramases për kryerjen e punimeve, projektin si dhe Përshkrimin teknik (specifikacionin teknik) dhe ne internet sqaroj se dëshmia e kërkuar nuk është në përputhje me nenin 7 dhe 28 të LPP-se, sepse gjatë kërkimit në Internet kam konstatuar se certifikata EN 13067:2013 e cila është kërkuar si dëshmi për “punëtorin për saldime nënë ujë” - i dedikohet personave të cilët aftësohen -certifikohen dhe shërben për këtë qëllim: “Ky dokument specifikon metodën e testimit të njohurive dhe aftësive të një saldatori që kërkohet të kryejë saldime në termoplastikë në ndërtime të reja dhe punë riparimi”. Në vazhdim janë dhënë të gjitha shënimet e marrura nga interneti për standardin e kërkuar EN

13067:2013. Përshkrimi i standardit EN 13067: 2013 i marr nga hulumtimi në faqet e Internetit - “UNI EN 13067 : 2013 PLASTICS WELDING PERSONNEL”.



UNI EN 13067: 2013

1 Hartëzuar



Shtoja tek lista e shikimeve

Shikimi i zëvendësuar nga

PERSONEL I SALDIMIT TË PLASTIKËS - PROVIMI KUALIFIKIMOR I ALDATORËVE - KUNDËR ME SALDATORË TERMOPLASTIKE

Data e lëshimit: 18-02-2021

Data e publikimit: 01-01-2013

Botuesi: Ente Nazionale Italiano di Unificazione (UNI)



UNI EN 13067 : 2013

Withdrawn



Add to Watchlist

View superseded by

PLASTICS WELDING PERSONNEL - QUALIFICATION TESTING OF WELDERS - THERMOPLASTICS WELDER ASSEMBLIES

Withdrawn date: 02-18-2021

Published date: 01-01-2013

Publisher: Ente Nazionale Italiano di Unificazione (UNI)

Ne këtë faqe të internetit përshkrimi tekstual i certifikatës EN 13067:2013 është si vijon:
Personeli i saldimit të plastikës - Kualifikimi i saldatorëve - Komplete të salduara me termoplastikë

Ky dokument specifikon metodën e testimit të njohurive dhe aftësive të një saldatori që kërkohet të kryejë saldime në termoplastikë në ndërtime të reja dhe punë riparimi. Ekzaminimi i aftësive të një salduesi është një kusht thelbësor për sigurimin e cilësisë së punës së saldimit. Zbatimi i këtij dokumenti garanton që ekzaminimi të kryhet sipas një procedure uniforme testimi. Ky dokument zbatohet kur kontraktori ose autoritetet përgjegjëse për aplikimin e kërkojnë atë. Industritë e rrjetit të gazit dhe ujësjellësit me programe alternative të kualifikimit janë të përjashtuara nga ky dokument.

Ky dokument zbatohet për proceset e mëposhtme të saldimit:

- saldimi me gaz të nxehtë: hundë e rumbullakët, shpejtësi, pykë;
- saldimi me nxjerrje;
- saldimi i veglave me ngrohje: shalë, fole, pykë;
- saldimi elektrofuzion: fole, shalë;
- saldimi me tretës: fole.

Ky dokument vlen për saldimin e produkteve të mëposhtme:

- fletë;
- tub (i pa përforcuar, vetëm mur i fortë);
- pajisje (vetëm të pa përforcuar);

- membrana e veshjes.

Ky dokument mbulon saldimin e grupeve të mëposhtme të materialeve:

a) për fletë, tuba dhe pajisje:

- Grupi 1: PVC (duke përfshirë të gjitha llojet e PVC-U, PVC-C) ose ABS;

- grupi 2: PP (përfshirë të gjitha llojet e PP);

- grupi 3: PE (përfshirë të gjitha llojet e PE);

- grupi 4: PVDF;

- grupi 5: ECTFE ose PFA ose FEP;

b) për veshjen e membranave dhe dyshemesë:

- grupi 6: PVC-P;

- grupi 7: PE (përfshirë të gjitha llojet e PE);

- grupi 8: BQE;

- grupi 9: PP;

c) vetëm për tubacione dhe pajisje:

- grupi 10: PA-U 11 ose PA-U 12.

Eksperti shqyrtues konstaton se kjo certifikate "EN 13067:2013" e kërkuar nga AK-ja nuk i përket certifikatës për Saldimin me metale, por sipas të dhënave në internet është certifikatë për saldim të plastikës dhe kërkesa si dëshmi e kësaj certifikate është e pa nevojshme dhe e gabuar. Ndërsa sa i përket certifikatës për saldim nënë ujë eksperti sqaron se në bazë të përshkrimit teknik dhe paramases së dhënë me projekt nuk parashihen punime me gypa të çelikut nënë ujë andaj kjo dëshmi e kërkuar për këtë aktivitet është i pa nevojshëm dhe redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik në bazë të nenit 7 dhe 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, pasi që sipas këtyre neneve, përpilimi i kushteve dhe kriterëve duhet të bëhet në përputhje me qëllimin dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, gjithmonë në përputhje me standardet e aplikueshme sipas ligjit. Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizës së projektit, paramases dhe përshkrimit teknik të aktiviteve ku është mundësia të punohet me saldime siç është pika 7- PAJISJET NË RRUGË-URË respektivisht pika 7.1 Parmaku metalik për këmbësorë – i cili është paraparë të punohen nga profilet rrethore nga metali dhe të cili do të punohet me saldim mbi ujë andaj si kriter të mbetet "Minimum një Punëtorë për saldime", dëshmia e kërkuar: të jetë i certifikuar për Saldim me certifikatë sipas standardit EN ISO 9606-1

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë –Vushtrri se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – Po ashtu ka kërkuar Inxhinier të diplomuar të Ndërtimtarisë, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik) në cilësinë e udhëheqësit të punishtes, ku për këtë inxhinier ka kërkuara që të jetë i certifikuar për saldim nënë ujë me certifikatë EN ISO 9606-1.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë – Vushtrri ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, projektit dhe përshkrimit teknik të projektit (Të cilin e kam pranuar në format elektronik - CD në bazë të kërkesës të drejtuar AK-së me datën 26.07.2022 dhe të pranuar me datën 29.07.2022 nga zyra e pranimit të ankesave në OSHP), në të cilin nuk specifikohet në asnjë aktivitet të punimeve të cilat do të punohen me metale siç janë: pika 4. PUNËT E ARMIMIT- nënë pika 4.1 Punët armaturës së brinjëzuar.- Shufrat e armaturës të janë nga çeliku i kualitetit S500H në përputhje me EN standardet dhe në asnjë detal të armimi, ashtu dhe në piken 7. PAJISJET NË RRUGË-URË – nënë pika 7.1 Parmaku metalik për këmbësorë- Të gjithë parmakët për këmbësor janë të përbëra nga profilet rrethore nga metali dhe nga elementet plotësuese vertikale dhe horizontale dhe për këto nuk është specifikuar se do të behet saldimi nënë ujë. Njëherë kriteri i kërkuar "një Inxhinier të diplomuar të Ndërtimtarisë, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik) në cilësinë e udhëheqësit të punishtes, ku për këtë inxhinier AK-ja ka kërkuar që të jetë i certifikuar për saldim nënë ujë me certifikatë EN ISO 9606-1" kjo kërkesë redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik sipas LPP-së neni 7 pika. 5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të punësojë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike. Pra kërkesa për: "Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik) në cilësinë e udhëheqësit të punishtes" ; dëshmia e kërkuar: "Inxhinieri të jetë i certifikuar për Saldim nën Ujë me certifikatë EN ISO 9606-1" redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik sepse ky person me këtë kualifikim dhe certifikatë është shume i paket apo s'ka fare në Kosovë andaj mendoj se është kriter

diskriminues dhe duhet të mos kërkohet për këtë inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë drejtimi i hidroteknikës që të jetë i certifikuar për saldim nënë ujë.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë –Vushtrri se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – AK-ja tek kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht tek kërkesa nënë a) ka kërkuar "Një (I) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, min. 8 vite përvojë pune pas diplomimit -Menaxher i Projektit, (drejtimi përgjithshëm)" ndërsa tek dëshmia dokumentare ka kërkuar "Inxhinieri të jetë i certifikuar për ndërtim të URAVE dhe duhet prezantoj min.3 kontrata për punët e dheut, ujësjellës dhe kanalizim".

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Në lidhje me pretendimin OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë –Vushtrri ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – Ekspertit shqyrtues sqaron se me datën 16. Shtator 2011 Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila ka nënshkruar vendimin për heqjen e procedurave të licencimit për subjektet ndërtimore.

Me këtë vendim shfuqizohen: Vendimi nr. 211, i datës 27.09.2005, "për procedurën e licencimit", i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Udhëzimi administrativ, nr. 2008/20, i datës 19.11.2008, "për dhënien e lejes, departamenteve, divizioneve në kuadër të institucioneve të Kosovës për kryerjen e punëve nga lëmi i projektimit në sektorin e ndërtimtarisë; Udhëzimi administrativ, nr. 10/2010, i datës 14.05.2010, "për licencimin e subjekteve ndërtimore"; si dhe Udhëzimi administrativ, nr. 02/2011, i datës 01.04.2011, "për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ, nr. 10/2010, për licencimin e subjekteve ndërtimore". Kështu që nga kjo datë janë shfuqizuar të gjitha certifikatat e licencimit dhe nuk janë lëshuar certifikata të reja. Kjo kërkesë bie ndesh me nenin 7 të LPP-se pika 5. Në të cilin thuhet: Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të punësojë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontratë publike. Dhe jo të vendoset si kriter vlerësues një certifikatë të cilën se posedon as një person apo kompani në Kosovë në bazë të Vendimit nr. 6959 datës 16.07.2011. Më poshtë po japim vendimin për heqjen e procedurave të licencimit për subjektet ndërtimore nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Kabineti i Ministres. :



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA QEVERIA I QEVERIS SE KOSOVES - KABINETI I MINISTRES - KABINETI I MINISTRA I KOSOVES	
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Ministry of Trade and Industry	Ministria e Punëve të Brendshme Ministry of Internal Affairs
№ i Orahut Serial Number	№ i Orahut Serial Number
Prishtinë, 16.09.2011	Prishtinë, 16.09.2011

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministres - Kabineti i Ministra - Cabinet of the Minister

Prishtinë, 16.09.2011

Ministria e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4, nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 8 të Rregullores nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/35 të datës 01.09.2011 merr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi Nr. 211 i datës 27.09.2005 "Për procedurën e licencimit" i lëshuar nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

2. Shfuqizohet:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/20 i datës 19.11.2008 "Për dhënien e lejes, departamenteve, divizioneve në kuadër të institucioneve të Kosovës për kryerjen e punëve nga lëmia e projektimit në sektorin e ndërtimitarisë;

- Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2010 i datës 14.05.2010 "Për Licencimin e Subjekteve ndërtimore" si dhe



- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2011 i datës 01.04.2011 "Për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr. 10/2010 për licencimin e subjekteve ndërtimore".

3. Obligohet Departamenti Ligjor i MTI-së, që të njoftojë Zyrën për Shërbime dhe Ndihmë Juridike (ZSHNJ) në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (ZKM), me qëllim të fshirjes së Udhëzimeve Administrative të përmenduar në paragrafin 2 të këtij Vendimi nga regjistri i akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga Qeveria dhe Ministri.

4. Obligohet Departamenti i Ndërtimitarisë që, për Vendimin e marrë të njoftojë Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRRPP-në), Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP-në), Agjencinë e Prokurimit Publik (APP-në), Drejtoritë e Urbanizmit dhe Departamentet e Prokurimit në Komuna.

5. Obligohet zyra e informimit në MTI, që këtë Vendim ta publikojë në web faqen zyrtare të MTI-së si dhe të informojë mediat elektronike dhe të shkruara.

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Mimoza KUSARI-LILA

Ministre e MTI-së


Vendimi i dërgohet:

- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit të Ndërtimitarisë;
- MAPL
- KRRPP;
- OSHP;
- APP;
- Arkivit të MTI-së.

Njëherë për këtë inxhinier është kërkuar si dëshmi se duhet të prezantoj min. 3 kontrata për punët e dheut, ujësjellës dhe kanalizim". Eksperti shqyrtues mendon se dhe kjo dëshmi e kërkuar redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik dhe propozon që ky kërkesë të ndryshohet dhe të formulohet në këtë mënyrë "duhet prezantoj min. 3 kontrata të kategorisë së ndërtimit të ultë" sepse ndërtimi i urës i përket kategorisë së objekteve të ndërtimit të ultë në të cilin ndërtim bëjnë pjesë kategoritë e ndërtesave sipas ndërlidhjes së funksionit me sistemin e infrastrukturës (rrugët, tunelet, urat, viaduktet, hekurudhat, aeroportet, infrastruktura nëntokësore, etj.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë –Vushtrri se AK – KUVENDI KOMUNAL I MTROVICES: Në dosje të tenderit në lidhje me pajisjet e kërkuara AK-ja ka përcaktuar kërkesën Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Të dorëzohet lista e pajisjeve mjeteve të punës [që OE duhet

t'i ketë në pronësi ose të ketë marrëveshje ose memorandum mirëkuptimi për marrje me qira të mjeteve të nevojshme për realizim të projektit]. Deklaratat doganore, faturat, librezat e qarkullimit valide-për automjetet që mund të regjistrohen."

Ndërsa tek lista e pajisjeve përkatësisht tek aneksi 7 ka kërkuar: në pikën 6. Makinë për saldim në ujë me specifika të veçanta për punë në ujë si dhe tek pika 7. Makinë prerëse e gypit nën ujë dhe saldim/largim.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Në lidhje me pretendimin OE "HAXHA KOM" SH.P.K. Gojbulë –Vushtrri ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË – Ekspertit shqyrtues sqaron se pajisjet e kërkuara sipas tabelës në Aneksi 7. LISTA E PAJISJEVE të Dosjes së Tenderit :

Pajisjet të tjera të nevojshme për punë specifike në UJË:

- a]. Makinë për SALDIM në ujë me specifika të veçanta për punë në ujë – sasia 1
- b]. Makinë PRERSE e gypit nën ujë dhe Saldim/Largim - sasia 1

Në baze të përgjigjeve që u dhanë më lartë nuk janë të nevojshme pasi që në asnjë aktivitet të punës nuk është paraparë që do të saldohen apo prehen gypa të çelikut me specifika të veçanta për punë nën ujë mirëpo eksperti shqyrtues rekomandon që këto pajisje prapë të kërkohen por me këtë përshkrim

Pajisjet të tjera të nevojshme për punë specifike:

- a]. Makinë për SALDIM të metalit – sasia 1
- b]. Makinë PRERSE e metalit - sasia 1

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat operatoreve ekonomik ankues të merren si të bazuar dhe propozon që të rekomandoj Autoritetin kontraktues -Komuna e Mitrovicës që të bëjë publikimin e sqarimeve shtesë:

Për mes faqes zyrtare të e-prokurimit me formularin standard B54- FORMULARI PER KORRIGJIMIN E GABIMEVE NË NJOFTIMET E PUBLIKUARA.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.08.2022, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur për të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues se autoriteti kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese, andaj, paneli shqyrtues në tërësi mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është se kërkesa e cekura në pretendimet ankimore të OE ankues, si të tilla paraqesin diskriminim. të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertëve shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës së tyre. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuar si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Vedat Poterqoi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK - "KK- Mitrovicë",

1x1 / OE- "Haxha Kom"SH.P.K.-Vushtri,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.